

L I G J
Nr.8456, datë 11.2.1999

**PËR FUNKSIONIN E PËRFAQËSUESIT LIGJOR PRANË ORGANIZMAVE
NDËRKOMBËTARË PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar pranë organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, bëhet nga përfaqësuesi ligjor.

Neni 2

1. Përfaqësuesi ligjor emërohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Drejtësisë.

2. Zyra e përfaqësuesit ligjor funksionon pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kjo zyrë përbëhet nga juristë dhe ndihmon përfaqësuesin ligjor në ushtrimin e kompetencave të tij.

3. Zyrtarët e ministrive dhe të organeve të pushtetit gjyqësor, veprimtaria e të cilëve ndikon drejtpërdrejt në përmbushjen dhe në respektimin e angazhimeve ndërkombëtare të vendit tonë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, bashkëpunojnë me përfaqësuesin ligjor për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare.

4. Për çështje të veçanta, përfaqësuesi ligjor kërkon mendimin e organizatave dhe shoqatave që ushtrojnë veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe ndihmën e specialistëve apo të avokatëve të huaj. Niveli i pagesave për këto shërbime përcaktohet, në çdo rast, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

1. Në marrëdhëniet me organizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës, përfaqësuesi ligjor gëzon një mandat me këto të drejta:

- Përfaqëson zyrtarisht shtetin shqiptar në të gjitha rastet e shtruara për shqyrtim para organizatave ndërkombëtare për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

- Komunikon rregullisht me to, duke u dërguar informacione, raporte dhe të dhëna të plota për raste konkrete dhe për situatën e përgjithshme të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

- Mbron interesat shtetërorë, argumenton qëndrimin e shtetit shqiptar dhe jep shpjegimet e duhura para institucioneve ndërkombëtare për rastet e veçanta që ato shqyrtojnë lidhur me Shqipërinë.

- Mban kontakte me to për përmbushjen e të gjitha detyrimeve apo angazhimeve të vendit tonë.

2. Për të siguruar përmbushjen e rregullt të detyrës së vet, përfaqësuesi ligjor ka këto kompetenca themelore:

- Bashkërendon veprimtarinë e rrjetit të zyrtarëve ligjorë në institucionet shtetërore dhe të

shoqatave e organizatave që ushtrojnë veprimtari në fushën e të drejtave të njeriut, për të siguruar përmbushjen në nivel të lartë të detyrimeve ndërkombëtare të vendit, në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe për të informuar, në mënyrë sa më të plotë dhe të frytshme, forumet ndërkombëtare për zhvillimet lidhur me të drejtat e njeriut në Shqipëri.

- Për rastet konkrete, të evidencuara në forumet ndërkombëtare, kërkon informacion të hollësishëm nga institucionet shtetëror, të cilat janë të detyruara të japin shpjegime të plota në kohën e duhur.

- Përgatit materialet përfundimtare për qëndrimin themelor për mbrojtjen e interesave shtetërore para institucioneve ndërkombëtare.

- Përcakton përbërjen e ekipit të ekspertëve, që do të bëjnë mbrojtjen e interesave shtetërorë, për rastet konkrete, para institucioneve ndërkombëtare.

- Udhëzon dhe u kërkon shpjegime zyrtarëve ligjorë për ndjekjen e çështjeve për zbatimin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ku vendi ynë është palë.

- Bën sugjerime për qëndrimin dhe masat që duhet të marrin Këshilli i Ministrave dhe institucionet shtetërore, në rastet kur ka ankesa për shkeljen e të drejtave të njeriut.

- Ndjek procesin e zbatimit nga autoritetet tona të vendimeve të organizatave ndërkombëtare për rastet e shqyrtuara të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

3. Të gjitha institucionet shtetërore janë të detyruara t'u përgjigjen brenda një periudhe dyjavore kërkesave të përfaqësuesit ligjor, në përmbushjen e rregullt të mandatit të tij zyrtar.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2323, datë 24.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**